



FILTO AUDITING

Raport i Transparencës 2022

Informacion për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

FILTO AUDITING Sh.p.k.

Përmbajtja

Hyrje	3
Struktura ligjore	4
Politikat e kontrollit të cilësisë	5
Shërbimet që Ofrojmë	6
Cilësia e Auditimit	7
Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve të Konsulencës të Raportimit Financiar dhe Taksave	8
Informacione financiare	9
Njësi ekonomike me interes publik (NIP)	10

Hyrje

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin e transparencës të Filto Auditing sh.p.k për vitin 2022.

“FILTO Auditing” sh.p.k është një shoqëri shqiptare me qendër në Tiranë, e përkushtuar ndaj profesionalizmit dhe efijencës në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe konsulencës.

Qasja jonë është përputhshmëria e cilësisë së shërbimeve me ambiciet e klientëve tanë, sado të mëdhej apo të vegjël që ata janë, për të punuar së bashku në partneritet dhe për të kërkuar së bashku zgjidhjet e duhura duke i mbeshtetur ata që të behen të suksesshem. Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që ata kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme. Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me ekspertizën e ekipit tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për më shume se shtatëmbëdhjetë vite, ne ofrojmë shërbime drejt një numri të madh klientësh brënda vendit, duke bashkuar praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare me njohuritë dhe eksperiencën tonë.

E themeluar në Tiranë në shkurt të 2006, “FILTO Auditing” është një shoqëri private e pavarur dhe dinamike dhe së fundmi ka punuar në auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, shërbime të tjera siç përshkruhen më poshtë, dhe trajnime në Shqipëri dhe Kosovë.

Partnerët tanë janë antarë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Politikat e kontrollit të cilësisë

Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigoroze të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë.

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit. Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standardet e larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Shoqëria ka procedura të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

- manualet teknike dhe proceduriale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;
- trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të partnerëve dhe punonjësve nepermjet trajnimit te IEKA-s;
- Vlerësim vjetor të stafit.

Shërbimet që Ofrojmë

Ne ofrojmë një portofol shërbimesh auditimi dhe konsulence për një bazë të diversifikuar klientësh. Shërbimet tona kryhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Ne mund t'ju asistojmë në auditim, kontabilitet, konsulencë, përgatitje, implementim, monitorim dhe vlerësim të organizatave, projekteve në:

- ✓ Auditim të pasqyrave financiare dhe kontroll ligjor të llogarive
- ✓ drejtim, pjesëmarrje dhe përgatitje të raporteve financiare mujore dhe vjetore në përputhje me SNRF-të dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,
- ✓ drejtim pjesëmarrje dhe mbështetje menaxhimi në punët e auditimit
- ✓ këshilla ligjore dhe taksash
- ✓ drejtim dhe pjesëmarrje të projekteve të punës së auditimit të brendshëm
- ✓ vlersime të specializuara, analiza, plane biznesi, monitorim dhe vlerësim
- ✓ projektim dhe ofrim të trajnimeve të auditimit të brendshëm, shërbimeve financiare dhe auditimin menaxherial
- ✓ përkthim, interpretim dhe editim të punimeve të specializuara.

Cilësia e Auditimit

Ne në Filto Auditing jemi të përkushtuar ndaj cilësisë në shërbimet që ofrojmë. Për këtë ne jemi angazhuar përmes zhvillimit të politikave dhe procedurave të përfshira në manualin e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, kontrollit të cilësisë, pavarësisë dhe etikës.

Rishikimi i Kontrollit të Cilësisë në Filto Auditing kryhet në nivel firme dhe në nivel angazhimi bazuar në politikat dhe procedurat e brendshme të hartuara në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Rishikimit të Kontrollit të Cilësisë 1 “Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të informacioneve financiare historike dhe angazhime të tjera të sigurisë dhe të shërbimeve të lidhura” dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Filto Auditing kryhet të paktën një herë në tre vjet. Procesi i Rishikimit të Cilësisë së Auditimit është hartuar për të monitoruar pajtueshmërinë e ekipit të angazhimit me standardet profesionale të auditimit dhe të etikës.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Filto Auditing kryhet nga partnerë të pavarur dhe të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. Përmes procesit të inspektimit shqyrtohen pasqyrat financiare, raportet e auditimit, letrat e punës dhe dosjet e angazhimit. Audituesi i cili kryen Rishikimin e Cilësisë së Auditimit vlerëson nëse ekipi i angazhimit ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme dhe raportet e lëshuara nga firma anëtare janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara. Këto përfshijnë përgjegjësitë e udhëheqjes për cilësinë, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, burimet njerëzore, ecurinë e angazhimit dhe monitorimin.

Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve të Konsulencës të Raportimit Financiar dhe Taksave

Shërbimet ne fushën e raportimit financiar dhe taksave konsiderohen si një çështje e rëndësishme për shumicën e shoqërive ndaj dhe ne në Filto Auditing i kushtojmë një vëmendje të veçantë ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë.

Mjedisi për planifikimin e taksave po bëhet gjithnjë e më tepër politik dhe i një profili të lartë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se ky mjedis dnamik nënkupton se klientët tanë kanë nevojë të vazhdueshme për konsulentë të besueshëm të cilët mund të adresojnë të gjitha nevojat e tyre në lidhje me legjislacionin tatimor, raportimin financiar dhe planifikimin tatimor.

Në vitet 2022 ne u përqendruam në përmirësimin e aftësive dhe ekspertizës së punonjësve tanë përmes programeve të trajnimit dhe në përforcimin e procesit tonë të rishikimit me qëllim ofrimin e shërbimeve më profesionale.

Shërbimet tona të konsulencës ndihmojnë klientët të krijojnë, transformojnë dhe mbrojnë vlerat e tyre. Gjithashtu ne ndihmojmë klientët tanëtë financojnë rritjen dhe optimizojnë operacionet e tyre, ne i këshillojmë ata se si të menaxhojnë riskun dhe mjedisin rregullator.

Informazione finanziare

Ndarja e të ardhurave të Filto Auditing sh.p.k për vitin 2022 është si në vijim:

<i>Shërbimi</i>	<i>për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 (të ardhurat në mijë lekë)</i>
Auditime të Pasqyrave Financiare të shoqërive	11,610
Auditime të Pasqyrave Financiare të Organizatave dhe Projekteve	1,784
Kontabilitete	2,241
Të tjera	534
Totali	16,168

Shpërblimi i partnerëve

Partnerët paguhen në bazë të pagës vjetore. Përveç kësaj, partnerët marrin edhe dividendë.

Njësi ekonomike me interes publik (NIP)

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat Filto Auditing Shpk ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 (audituar gjatë vitit 2022) është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 5.03.2009 ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", te ndryshuar

“Njësi ekonomike me interes publik” janë:

- ✓ të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- ✓ bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- ✓ shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- ✓ shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2022, Filto Auditing Shpk kreu auditimin për enitet me interes publik per Pasqyrat Financiare të vitit 2021 si më poshtë:

Shoqëria	Aktiviteti
Gener 2	Ndërtim, Qendër Biznesi, Tregti.
Edil Al It	Ndërtim,
Ujësjiellës Kanalizime Elbasan	Prodhim e shpërndarje uji të pijshëm
M PAY	Shoqëri Financiare
Tring TV	Televizion
Media Vizion	Televizion
Bleta	Internet
Albanian Satelite Communication	Internet
Digicom	Internet
G2 Media	Televizion
Albanian Telecommunication Union	Internet
Dragobia Energy	Hidrocentral

Në bazë të VKM 17 dt.16.01.2020 shoqëritë Gener2 dhe Edil AI It klasifikohen NIP për shkak të madhësisë së biznesit. Shoqëria Ujsjellës Kanalizime Elbasan klasifikohet NIP për shkak të natyrës së biznesit ku shteti ka pjesëmarje në kapital. Shoqëria M PAY klasifikohet NIP pasi është institucion financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë si institucion financiar jo-bankë.

Shoqëritë Media Vizion, Tring Tv, Bleta, Albanian Satelite Communication, Digicom, G2 Media, Albanian Telecommunication Union klasifikohen si Njësi me Interes Publik si shoqëri të cilat ofrojnë një të mirë publike në aktivitetin e tyre tregtar dhe janë subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse, që janë AMA dhe AKEP.

Shoqëria Dragobia Energy si shoqëri e cila ofron një të mirë publike në aktivitetin e saj tregtar dhe është subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse, përkatësisht Entit Rregullator të Energjisë.